

V E N D I M
PER RIREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 18.3.1994, une gjyqtarja e gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi THOMA SIMAKU, per riregjistrimin e Ndermarjes 2" SIMAKU", ne formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar 2 SIMAKU 2 SHPK dhe:

K O N S T A T O V A

Me vendimin Nr. 432 date 18.3.1994, kerkuesi THOMA SIMAKU eshte brivendosur ne afat per te paraqitur dokumentacionin perkates per riregjistrimin e Ndermarjes Private " SIMAKU", ne formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar " SIMAKU" SHPK per te ushtruar veprimtarine private ne fushen e:

* Punime dheu, muratura, betone, beton) arme te zakoneshme, punime shembjesh.

* Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj, dhe komiteti me instalimet e nevojeshme per to.

* Punime restaurimi.

* Punime te shtresave te rrugeve.

* Ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore.

* Prodhime dhe tregetime te materialeve te ndertimit.

* Si dhe qdo aktivitet tjeter qe veqmas ose se bashku me ato te permendura me larte do te konsiderohen te pershtateshme per rritjen dhe zhvillimin e Shoqerise.

Kapitali i Shoqerise eshte 600 000 leke.

Selia e Shoqerise eshte ne qytetin e Korçes, Rr; "Midhi Kostani " P.6, ap.8.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise do te jete me afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Administratore i Shoqerise do te jete THOMA SIMAKU.

Nga shqyrtimi i dokumentave te paraqitura rezultan se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar

PER KETO ARESYE

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7512 date 10.8.1991, ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit 7667 date 28.1.1993

V E N D O S A

Riregjistrimin si Person Juridik te Ndermarjes "SIMAKU"

ne formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar "SIMAKU" SHPE
me ortake te vetem THOMA SIMAKUN, per te ushtruar veprimtarine private ne
fushen e:

* Punime dhe, muratura, betone, beton arme te zakoneshme, punime
shembjesh.

* Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj dhe kompi
pletime me instalimet e nevojeshme per te.

* Punime restaurimi

* Punime te shtresave te rrugeve

* Ndertime vepra arti rrugore dhe hekuradhore

* Prodhime dhe tregetime te materialeve te ndertimit

* Si dhe gdo aktivitet tjeter qe veqmas ose se bashku me ato te
permendura me siper do te konsiderohen te pershtateshme per rritjen dhe
zhvillimin e shoqerise.

Kapitali i Shoqerise eshte 600 000 leke

Selia e Shoqerise eshte ne qytetin e Korces, Rr. Midhi Kostani

P.6, ap.8.

Kohезgјatја e veprimtarise ekonomike e Shoqerise do te jete
me afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Administratore i Shoqerise eshte THOMA SIMAKU.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte

G J Y Q T A R E

Beutka / Doli
Shaf

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. _____

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 11 04.2003, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Thoma Simaku, i cili kerkon depozitimin e VENDIMIT TE ORTAKUT TE VETEM, date 11.04.2003 dhe ;

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 2833, date 18.03.1993 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar SIMAKU SHPK ; me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku, me kapital fillestar 100.000 leke, me seli ne Korce.

Me vendimin nr.1 , date 11.04.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ;

1. Caktimi i ekspertit kontabel i miratuar z. Fatmir Ceci.

2. Eksperti do te vleresoje rritjen e kapitalit te shoqerise SIMAKU

SHPK

Kerkesa e tij per t'u pasqyruar keto ndryshime edhe skeden e kesaj shoqerie prane Zyres se Regjistrimit Tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare ;

V E N D O S A :


Pranimin e kerkeses.

Te depozitohet vendimi date 11.04.2003 i ORTAKUT TE VETEM TE shoqerise SIMAKU SHPK ku eshte vendosur caktimi i ekspertit Fatmir Ceci per shtesen e kapitalit te shoqerise ne natyre , duke u bere ndryshimet perkatese ne Skenden e Kesaj Shoqerie ne kollonen 4 e 5 dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

ANILA CAPO

REPUBLIKA E SHQIPERISE



GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 2833/1

V E N D I M
I G J Y Q T A R E S S E V E T M E

Sot, me date 18 04.2003, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Thoma Simaku, i cili kerkon depozitimin e **VENDIMIT TE ORTAKUT TE VETEM**, date 11.04.2003 dhe ;

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 2833, date 18.03.1993 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **SIMAKU SHPK**, me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku, me kapital fillestar 100.000 leke, me seli ne Korce.

Me vendimin nr.1, date 11.04.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ;

1. Caktimi i ekspertit kontabel i miratuar z. Fatmir Ceci.

2. Eksperti do te vleresoje rritjen e kapitalit te shoqerise **SIMAKU**

SHPK

Kerkesa e tij per t'u pasqyruar keto ndryshime edhe skeden e kesaj shoqerie prane Zyres se Regjistrimit Tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.


PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare ;

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Te depozitohet vendimi date 11.04.2003 i **ORTAKUT TE VETEM TE shoqerise SIMAKU SHPK** ku eshte vendosur caktimi i ekspertit Fatmir Ceci per shtesen e kapitalit te shoqerise ne natyre, duke u bere ndryshimet perkatese ne Skenden e Kesaj Shoqerie ne kollonen 4 e 5 dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.



GJYQTARE

ANILACAPO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. _____

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 11/09.2003, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Thoma Simaku, i cili kerkon depozitim e **VENDIMIT TE ORTAKUT TE VETEM**, date 09.05.2003 dhe ;

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 2833, date 18.03.1993 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar SIMAKU SHPK , me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku, me kapital fillestar 600.000 leke, me seli ne Korce.

Me vendimin nr.1 , date 11.04.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ;

1. Caktimi i ekspertit kontabel i miratuar z. Fatmir Ceci.

2. Eksperti do te vleresoje rritjen e kapitalit te shoqerise SIMAKU SHPK

Me vendimin nr.2 , date 09.05.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ;

1. Miratimi i aktit te ekspertimit nga z. Fatmir Ceci kontabel i miratuar, ku mbas bilancit te vitit 2002 fitimi + rezerva eshte ne shumen 15.305.090 leke dhe kontributi ne natyre eshte 10.307.025 leke . Pra kapitali i shoqerise rritet ne shumen 25.612.115 leke.

Kerkesa e tij per t'u pasqyruar keto ndryshime edhe skeden e kesaj shoqerie prane Zyres se Regjistrimit Tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare ;

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Te depozitohet vendimi date 09.05.2003 i ORTAKUT TE VETEM TE shoqerise SIMAKU SHPK ku eshte vendosur miratimi i aktit te ekspertimit nga z. Fatmir Ceci kontabel i miratuar, ku mbas bilancit te vitit 2002 fitimi + rezerva eshte ne shumen 15.305.090 leke dhe kontributi ne natyre eshte 10.307.025 leke. Pra kapitali i shoqerise rritet ne shumen 25.612.115 leke. duke u bere ndryshimet perkatese ne Skenden e Kesaj Shoqerie ne kollonen 4 e 5 dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE


EPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR.2833/3

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 06 . 05.2005 une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se are Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Thoma Simaku, i cili kerkon depozitimin e vendimit date 21.04.2005 per shtese objekti te shoqerise "SIMAKU" SHPK dhe;

KONSTATOVA SE :

Shoqeria "SIMAKU" SHPK eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.2833, date 13.03.1994, prane gjykates se Rrethit Tirane me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku, me seli ne Korce.

Me vendimin nr.2833/1 dhe 2833/2 kjo shoqeri ka bere shtese kapitali. Me vendimin e Ortakut te Vetem date 21.04.2005 eshte vendosur shtesa e objektit te veprimtarise ne fushen e ndertimeve hidraulike dhe hidroteknike e- Ndertim Diga damba deri ne 10 m. Prodhim i materialeve inerte me mjete mekanike dhe me lende plasese (eksplozic) dhe tregtimin e tyre. Prodhim i materialeve te ndertimit sipas klasifikimit a) Prodhim i materialeve inerte gure b) prodhim qeramike tulla, tjegulla, fajance c) Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme, paranderur - gurdekorativ d) Prodhim materiale lidhese gelqere, allci, cemento e) Prodhim i materialeve me baze bitumi sintetike.

Per sa me siper, nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.


PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7667 , date 19.11.1992 " Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhet te plotesohen ne te",

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitimin e vendimit date 21.04.2005 te shoqerise "SIMAKU" SHPK per shtese objekti .

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregtar, ne kollonen nr.4,5 duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 2833/4

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 06.09.2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.3 date 15.07.2005 te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "SIMAKU"sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.1833, dt. 18.03.1993 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "SIMAKU" sh.p.k me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku me seli ne Tirane, me kapital fillestar 100.000 leke..

Me vendimet 2833/1 dhe 2833/2 kjo shoqeri ka bere shtese kapitali dhe mbas kesaj shtese kapitali i shoqerise eshte 25.612.115 leke.

Me vendimin nr.3 te ortakut te vetem date 15.07.2005 eshte vendosur :

1. Te caktoje si eksperte Vangjush Postoli per shtesen e kapitalit te shoqerise .
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimin e vendimit nr. 1, dt. 15.07.2005 te ortakut te vetem ne regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"


V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te e vendimit nr.3, dt. 15.07.2005 te ortakut te vetem THOMA SIMAKU te shoqerise tregtare "SIMAKU"sh.p.k per caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar per shtesen e kapitalit .

Te behen ndryshimet perkatese duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
BDERINA MUÇA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 2833/5

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 28 09.2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.3 date 12.09.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare “” SIMAKU”sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr.1833, dt. 18.03.1993 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare “ SIMAKU” sh.p.k me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku me seli ne Tirane, me kapital fillestar 100.000 leke..

Me vendimet 2833/1 dhe 2833/2 kjo shoqeri ka bere shtese kapitali dhe mbas kesaj shtese kapitali i shoqerise eshte 25.612.115 leke.

Me vendimin nr.3 te ortakut te vetem date 15.07.2005 eshte vendosur :
Te caktoje si ekspert Vangjush Postoli per shtesen e kapitalit te shoqerise .
Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Me vendimin nr.4 te Ortakut te vetem date 12.09.2005 eshte vendosur :

1. Te miratoje raportin e rritjes se kapitalit te nenshkruar te shoqerise ‘ SIMAKU’ shpk te vleresuar nga eksperti kontabel i autorizuar z. Vangjush Postoli , e cila nga 25.612.115 leke behet ne 38.353.907 leke.
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndryshimeve prane regjistrin tregtar.
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 “Per regjistrin tregtar”

V E N D O S A


Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te e vendimit nr.4 dt. 12.09.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare “ SIMAKU”sh.p.k ku eshte vendosur miratimi i raportit te rritjes se kapitalit te nenshkruar te shoqerise ‘ SIMAKU’ shpk te vleresuar nga eksperti kontabel i autorizuar z. Vangjush Postoli , e cila nga e cila nga 25.612.115 leke behet ne 38.353.907 leke.

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonen nr.2, germa “ç” duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

BLERINA MUÇA



AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE PRIVATE NDERTUESE DHE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SIMAKU" SH.P.K.

Ne Tirane, sot me date 11 Mars 1994 (nentedhete e kater) une i nenshkruari Thoma Simaku, i biri i Mitit dhe i Marianthit, i datelindjes 1945, lindur ne Korçë dhe banues ne Korçë, Rr. Midhi Kostani, Pall.6, Ap.8 me cilesine e ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote, vendosa te krijoj, shoqerine private ndertuese dhe tregtare "Simaku" Shpk.

HYRJE

Ne kuptim te ketij akti themelues, ortaku i vetem Thoma Simaku eshte themeluesi i shoqerise private tregtare "Simaku" Shpk.

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i shoqerise private tregtare "Simaku" Shpk. me qender ne Korçë dhe shtrirja ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria private tregtare "Simaku" Shpk. Korçë rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me aktin e themelimit, statusin e saj, me ligjin Nr. 7512 date 10 Gusht 1991, Kodit Tregtar (Ligji Nr. 7638 date 19 Nentor 1992) dhe akte te tjera te legjislacionit shqiptar.

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise private te shoqerise "Simaku" Shpk. do te jete aktiviteti i gjithanshem ne fushen e ndertimit dhe tregtise me shumice dhe me pakice, import eksport brenda dhe jashte vendit si dhe transportimin e tyre i percaktuar hollesisht ne statusin e shoqerise, bashkangjitur ketij akti.

AFATI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e Shoqerise do te jete efektive nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtare prane Gjykates se Rrethit te Tiranes, si dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organet kopetente.

Aktiviteti privat do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.





KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltare i Shoqerise “Simaku” Shpk. Korçë perbet nga kontributi fillestar i ortakut te vetem themelues z. Thoma Simaku i cili arrin ne vleren prej 600,000 leke.

Ortaku i vetem themelues ose persona te autorizuar prej tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore, te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore, sigurimet shoqerore, etj.

Per shkelje te ndryshme e te mundeshme te parashikuara ne statut, ortaku themelues mund te marre masa ndeshkimore ndaj kujdo qe demton pasurine e shoqerise.

JURIDIKSIONI

Shoqeria “Simaku” Shpk. e ka qendren ne qytetin e Korçës, Rr. Midhi Kostani, Pall.6, Ap.8.

Te gjitha mosmarreveshjet me personat juridike e financiare, vendas dhe te huaj si dhe organet shteterore, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, zgjidhja e tyre mund te behet nga Gjykata e Rrethit Tirane.

THEMELUESI

THOMA SIMAKU





STATUTI

I SHOQERISE PRIVATE NDERTUESE DHE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SIMAKU" SHPK.

Ne baze te ligjit Nr. 7512 date 10 Gusht 1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", te Kodit Tregtar dhe te akteve te tjera ligjore, ne Tirane, sot me date 11 Mars 1994, shtetasi THOMA SIMAKU, banues ne Korçë, Rr. Midhi Kostani, Pall.6, Ap.8, me vullnetin e tij te lire e te plote, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, vendosi te krijojë Shoqerine Private me Pergjegjesi te Kufizuar "SIMAKU" Shpk. Korçë.

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "SIMAKU" Shpk. Korçë eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjen Nr. 7512 date 10 Gusht 1991, Kodit Tregtar dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesi i Shoqerise ne kete siper marrje ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria "SIMAKU" Shpk. Korçë, është person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit te Tiranës dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.

EMRI, QENDRA, TERRITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete:

"Shoqeria Private Ndertuese dhe Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "SIMAKU" Shpk. Korçë

Neni 6

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Korçës, Rr. Midhi Kostani, Pall.6, Ap.8.

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te cele filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.

OBJEKTI

Neni 7

Objekti i veprimtarise dhe aktivitetit te kesaj shoqerie private ndertuese dhe tregtare do te jete:

* punime dheu, muratura, betone, beton arme te zakonshme, punime shembjesh.

* Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. dhe kompletime me instalime te nevojshme per to.

* Punime restaurimi.

* Punime te shtresave te rrugeve

* Ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore

* Prodhime dhe tregtime te materialeve te ndertimit.

* Si dhe cdo aktivitet tjeter qe vecmas ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohen te peshtatshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti tregtar i Shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin saj.

Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare brenda, 2 vjetesh mund te behet me lejen e organeve perkatese.





KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise "SIMAKU" Shpk. perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleften prej 600,000 lekesh.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Neni 11

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditura asaj.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

Neni 13

Pjese te kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe personave te trete, qe nuk bejne pjese ne Shoqeri me pelqim te themeluesit te shoqerise. Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 14

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, me mareveshje, pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 15

Shoqeria "SIMAKU" Shpk. Korçë do te kete si administrator z. THOMA SIMAKU. Themeluesi i shoqerise ka ne kopetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut.

Neni 16

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. i mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise.

Neni 17

Ne maredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve, qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kopetencen e themeluesit te shoqerise.

Neni 18

Ortaku i vetem themelues ka ne kopetence:

- * Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujore, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- * Vendos per shperberjen e shoqerise.
- * Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- * Rregullon marrdheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.
- * Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike vendas a te huaj.
- * E te tjera.

Neni 19

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posacerisht nga ortaku themelues, ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe ka te drejte te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

Neni 20

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaku i vetem themelues i shoqerise. Ne rastin e fundit, shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te themeluesit te shoqerise. Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

K R E U II

MAREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 21

Shoqeria "SIMAKU" Shpk. mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore, drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike vendas a te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport import.


Neni 22

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga THOMA SIMAKU ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 23

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.





Neni 24

Sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve të tjera ligjore, shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqërore, etj. Sipas ligjeve të tatimit mbi fitimin përcaktohen tatimet për veprimtarinë tregëtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë të çele llogaritë likuiduese pranë bankave të vendit, të huaja në Shqipëri dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre.

Neni 25

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetfinancohet në lekë ose valute të huaja.

Neni 26

Shkëmbimin e monedhës shqiptare me monedhe të huaja e anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lirë privat të valutes.

Neni 27

Të ardhurat nga veprimtaria private, do të sigurohen sipas çmimeve që i cakton vetë shoqëria. Cmimet dhe tarifatat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

Neni 28

Shoqëria ka të drejtë të transferojë jashtë shtetit kapitalin dhe pjesën e saj të fitimit në valute. Për pjesën e fitimit që transferohet jashtë shoqëria paguan një tatim 10% të shumës së fitimit që transferohet.

Neni 29

Për pasqyrimin e aktivitetit tregëtar administratori ose persona të tjerë të caktuar nga ortaku i vetëm themelues, janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas ligjit të vecantë.

Neni 30

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron në muajin Dhjetor të çdo viti. Administratori është i detyruar të paraqesë bilance periodike, bilance vjetore së bashku me deklaratën e fitimeve dhe humbjeve dhe të depozitojë ato në organin financiar të juridiksionit përkatës ku ushtron aktivitetin shoqëria.

K R E U III

MAREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 31

Themeluesi i shoqerise vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise " SIMAKU " Shpk.

Neni 32

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise pasi te jete marre me pare pelqimi i themeluesit te shoqerise, ose nga vete ortaku themelues qe ka dhe detyren e administratorit.

Neni 33

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

Neni 34

Ortaku i vetem, ortaket ne rast se shtohet numri i tyre, administratori dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar te respektojne disiplinën e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

Neni 35

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise zbatohen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikës se Shqiperise.

Neni 36

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kriterëve te caktuara nga ortaku i vetem themelues, ose nga ortaket kur jane disa te tille dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate, sipas ligjeve te shtetit shqiptar.

Neni 37

Punonjesit e gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kriterëve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas Kodit te Punes te Republikës se Shqiperise.

Neni 38

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku themelues zoti THOMA SIMAKU. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.



Neni 39

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te beje dorezimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesiperm mbahet nga administratori i shoqerise.

ELEMENTE TE TJERA

Neni 40

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise ekonomike tregetare, shoqeria mund te marre truall per ndertim me qira ose ne pronesi, si dhe o'bjekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante.

Neni 41

Dhenja e truallit dhe e objekteve dhe vlefte perkatese e tyre percaktohen nga organi financiar ne juridiksionin e te cilit ndodhet objekti ose trualli, ne baze te kriterëve te Keshillit te Ministrave dhe sipas kerkeses dhe ofertes ne mareveshje me persona juridike e fizike vendas.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 42

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore, etj., kalojne ne pronesi te ortakut te vetem themelues ose te ortakeve ne se ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te secilit.

Neni 43

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise " SIMAKU " Shpk. Korçe, caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi i shoqerise ose nga ortakët, ne rast se shtohet numuri i tyre.

Neni 44

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze.

Neni 45

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e mepareshme.

Neni 46

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, ndahet midis ortakeve sipas kontributit te sejcilit ose i mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere.



Neni 47

Pitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimorese dhe pagesat e mundeshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 48

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortakut themelues vendos brenda kater muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

Neni 49

Gjykata mund ti afroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne ditën ne te cilen ajo mblidhet per te marre vendim.

Neni 50

Ne rast se shoqeria nuk priset, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar, duke patur parasysh qe shuma e kapitalit te mbetur te jete mbi 100,000 leke.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 51

Themeluesi ne rastin e shtimit te numurit te ortakeve ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartoje dhe kontraten e perbashket me ortakët e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 52

Mosmareveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 53

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet Ligjes Nr.7512 date 10 Gusht1991, Kodit Tregetar te Republikës se Shqiperise si dhe cdo akti tjeter ligjor te legjislacionit shqiptar.



Neni 54

Statuti perpilohet ne disa kopje per tju dorezuar organeve kopetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SIMAKU" Shpk. Korçë.
U nenshkrua ne Tirane, sot me date 18 Mars 1994.

**ORTAKU I VETEM
THOMA SIMAKU**




**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA**


Nr. rep. 5207
Nr. kol. 2984


VERTETIM

Sot me date 18.3. 1994 (nentedhjete e kater) u paraqit personalisht para meje noteres ne Zyren e Noterise Tirane, Thoma Simaku, ortak i vetem i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SIMAKU" Shpk., madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tij personal, i cili deklaroi se sa me siper eshte statuti i shoqerise i perpiluar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire e te plote, nenshkruhet rregullisht perpara meje dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht sipas ligjes.




NOTERE :





2833/1



KERKESE

KERKUES : Thoma Simaku, me cilesine e ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise SIMAKU SHPK, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

OBJEKTI ; Depozitim i Vendimit te Ortakut te Vetem te dates 11.04.2003 per shtesen e kapitalit ne baze te nenit 63 i ligjit 7638, date 19.11.1992 Per regjistrin tregtar

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendimin nr. 2833, date 18.03.1993 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar SIMAKU SHPK , me ortak e administrator te vetem Thoma Simaku, me kapital fillestar 100.000 leke, me seli ne Korce.

Me vendimin nr.1, date 11.04.2003 te Ortakut te Vetem eshte vendosur ;

1. Caktimi i ekspertit kontabel i miratuar z. Fatmir Ceci.
2. Eksperti do te vleresoje rritjen e kapitalit te shoqerise SIMAKU

SHPK

Kerkoj te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrin Tregtar prane Gjykates suaj.

ADMINISTRATORI
THOMA SIMAKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 1227 Rep.

VERTETIM

